



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA PATOS**  
KËSHILLI I BASHKISË  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1162 Prot.

Patos, më 15/05 / 2026

**PROCESVERBALI I TAKIMIT 12 MAJ 2026**

**Vendi:** Pranë ish shkollës Drenie

**Ora e fillimit:** 13:00

**Ora e mbarimit:** 14:00

**Dëgjese publike me temë: “Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin Paketa e Maleve”.**

**Baza Ligjore:** Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1162 prot, datë 01.04.2026 të drejtorisë së Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile për zhvillimin e dëgjësës publike me temë: Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin në “Paketën e Maleve”.

**Pjesëmarrës:** Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj, Kryetar i Bashkisë Patos, z. Fation Duro, Zv/Kryetar znj. Ina Sauli, Drejtore znj. Boreta Murati etj, me pjesëmarrjen e *11 pjesëmarrësve (banorë, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të bashkisë Patos etj)*

**Kryetar i Bashkisë, z. Fation Duro**— Përhëndetje të gjithëve! Qëllimi i këtij takimi është të informojmë mbi Paketën e Maleve dhe ju të shprehni interesin mbi këtë proces. Zona prioritare në Patos do të jenë të shtrira në komplet njësinë administrative Ruzhdie, Kuqarin.



**Kryetar i Bashkisë  
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:**

**Dëgjese publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”**

**Mai 2026**

Në pjesën e dytë mund të shtohet dhe Rrerësi me Rusinjën. Ideja e Paketës së Maleve është që personat që janë posedues të tokës, por jo pronarë dhe që kanë marrë një tokë për ta zhvilluar në kuadër të turizmit mund të aplikoj në Paketën e Maleve dhe do të mund të kenë një mënyrë për ta zhvilluar me hapa shumë të shpejt. Kjo është një nismë e qeverisë që nga viti 2025 dhe ideja është që të zhvillohen zonat që kanë potencial. Kjo është një mënyrë që për ata persona që kanë një tokë që e posedojnë për më shumë se 10 vjet, të kenë mundësi për ta zhvilluar dhe përfituar tokën në fund me dokument pronësie. 500 përfituesit e parë janë të përjashtuar nga taksat. Aplikohet me dokumentacionin që parashikon ligji 20/2025 Për Paketën e Maleve. Edhe poseduesit që kanë një tokë por nuk po e certifikojnë dot atë me dokumentacionin që kanë, mund të aplikojnë me një plan biznesi për ta zhvilluar në vitet e ardhshme. Pasi bëhet aplikimi për të qënë pjesë e Paketës së Maleve mbas miratimit të zonave prioritare, bëhet kërkesa, më pas shqyrtohet nga bashkia dhe Këshilli Bashkiak. Më pas hartohet Plani i investimeve nga personat që do përdorin këtë tokë, del leja përkatëse në Ministri dhe më pas dokumentacioni paraqitet për të bërë blerjen e tokës me vlerën prej 1 lekë. ASHK në momentin e miratimit të zonës prioritare në secilën bashki, fillon rregjistrimin fillestar me procedura të përshpejtuara. Rishikohet dhe njëher harta dhe vazhdon procedura. Pra edhe njëherë kjo bëhet vetëm për toka që janë shtet dhe personi është posedues për një periudhë jo më pak se 10 vjet. Kjo vërtetohet nëpërmjet faturave tatimore, ortofotot e ndryshme që tregojnë zhvillimin e zonës, dhe mënyrave të tjera që tregojnë që kjo tokë ka qënë në përdorim të personit që aplikon. Duhet edhe vërtetim nga kryeplaku i zonës. Kjo pronë qëndron e afishuar rreth 45 ditë dhe nëse ka pretendime të tjera për atë tokë vendosen në dijeni. Shpresoj që për zonën e Drenies të ketë interes për Paketën e Maleve.

**Banor i Drenies, z. Arben Yzeiri**– Përshëndetje! Mund të aplikojmë para kohe ne pa u miratuar zonat akoma ose të zhvillojmë biznesin pa bërë aplikimin? Dhe sa zgjat procedura nga momenti i aplikimit?



**Banor i Drenies  
z. Arben Yzeiri**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”  
Maj 2026**

**Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro-** Duhet të miratohen zonat prioritare fillimisht në mënyrë që të aplikoni. Nuk aplikoni dot pa u miratuar zonat, sepse duhet të marrësh konfirmim fillimisht.



**Kryetar i bashkisë Patos  
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”**

**Maj 2026**

**Banor i fshatit Drenie, z. Fatmir Yzeiraj** – Në planin e biznesit është e përcaktuar vetëm agroturizëm apo mund të aplikosh edhe në bujqësi dhe fusha të tjera? Sa është çmimi i tokës që do përfitojmë? Besoj se toka do ketë disa kushte që ta përfitojmë përfundimisht?



**Banor i fshatit Drenie  
z. Fatmir Yzeiraj**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”**

**Maj 2026**

**Kryetar i Bashkisë Patos, z. Fation Duro-** Nga momenti i aplikimit procedura zgjat rreth 2 muaj ose 3 muaj, pasi duhet të bëhet dhe procedura e afishimit 45 ditor për pretendentë të tjerë. Tokën e përfiton me 1 lekë të gjithë tokën dhe bëhesh pronar i tokës që ke. Planin e biznesit mund të bëhet dhe në bujqësi apo fusha të tjera. Lidhur me tokën do paraqisni dokumentacionet që kërkohen dhe deklaratat e kryeplakut dhe banorë të zonës që vërtetojnë se ju e keni poseduar këtë tokë për më shumë se 10 vite.

**Banor i fshatit Drenie, z. Arben Yzeiri-** A është kusht që duhet të jesh banor i bashkisë që po aplikon? Sepse unë mund të mos jem banor i zonës këtu, por kam një tokë që e përdor prej shumë vjetësh. Unë e kam pasur këtu vendbanimin, por e kam ndryshuar momentalisht, por dua ta sjell përsëri.



**Banor i fshatit Drenie  
z. Arben Yzeiri**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”  
Maj 2026**

**Drejtores e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile, znj. Boreta Murati**- Ti mund të bësh saktësimin e adresës në portalin e Albania dhe kjo zgjidhet shumë thjesht duke e kaluar adresën në Drenie përsëri.



**Drejtores e Zhvillimit të Territorit dhe  
Emergjencave Civile  
znj. Boreta Murati**  
**Dëgjesë publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin  
Paketa e Maleve”  
Maj 2026**

**Banor i fshatit Drenies, z. Kastriot Lazaj** – I vetmi fshat në bashkinë Patos që nuk ka rrugë jemi ne. Drenia nuk ka rrugë. Rruga e vjetër që ka qënë më herët është prishur e gjitha. Në qoftë se nuk e bëjmë rrugën nga Vloshi, të bëjmë rrugën nga Gjynoqara. Ne nuk duam asfalt, por të rregullohet rruga me rërë që të kalojmë. Duhet edhe çakull në disa rrugë të tjera në Drenie.



**Banor i fshatit Drenies  
z. Kastriot Lazaj**  
**Dëgjesë publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”  
Maj 2026**

**Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro** – Për rrugën në Drenie ne mund të ndërhyjmë deri në pjesën tonë ku ndajmë me Roskovecin. Për rrugën e Drenies nga Gjynoqara do shikojmë mundësinë për rërë bituminoze.



**Kryetar i bashkisë Patos  
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”**

**Maj 2026**

**Banor i fshatit Drenie, z. Arben Yzeiri**—Gjatësia e rrugës deri të shkolla atë të NFP në atë kohë e matnin deri në 19 km nga Fieri deri në Drenie, por sot e matur deri këtu është 21 km. Është një gjatësi e konsiderueshme nga Vloshi. Prandaj dhe ne kërkojmë mundësinë me të shkurtër nga Gjynoqara.



**Banor i fshatit Drenie  
z. Arben Yzeiri**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”**

**Maj 2026**

**Banor i fshatit Drenie, z. Bashkim Aliaj** – Nga ura rruga është 2.7 km të paktën shtroni 2



**Banor i fshatit Drenie  
z. Bashkim Aliaj**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”**

**Maj 2026**

km. Makinat u prishën të gjitha nuk kalon dot. Të gjithë fshatrat e tjerë këtej ngjitur të Roskovecit janë me asfalt, vetëm ne jemi shumë keq në Drenie. Në kohën e ullirit është shumë problem sepse makinat me ngarkesë nuk kalojnë dot fare.

**Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro-** Rrugën në korrik do përpiqemi të ndërhyjmë me rërë bituminoze.



**Kryetar i bashkisë Patos  
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”**

**Maj 2026**

**Banor i fshatit Drenie, z. Arben Yzeiri-** E kam diskutuar disa herë dhe me administratorin



**Banor i fshatit Drenie  
z. Arben Yzeiri**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për  
aplikimin Paketa e Maleve”**

**Maj 2026**

për pjesën e tumbinove këtu që duhen hequr dhe duhen vendosur përsëri sespe pengojnë.

**Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj-** Nëse nuk keni diçka tjetër, do e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjesë publike.

**Koordinator i Konsultimit Publik**

Simela Shahinaj

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

Refaela Xeba